

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	<i>ver. 0.3</i>	<i>faqe 1 nga 39</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi Afatmesëm</i>

BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE 2025

Janar 2025

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	<i>ver. 0.3</i>	<i>faqe 2 nga 39</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi Afatmesëm</i>

Përmbajtja:

HYRJE	4
BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	5
KRITERET E HARTIMIT TË BILANCIT VJETOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE.....	6
1. KAPACITETET E INSTALUARA TË ENERGJISË ELEKTRIKE.....	7
1.1. KAPACITETET E INSTALUARA NË TC KOSOVA A dhe TC KOSOVA B	7
1.2. KAPACITETET E INSTALUARA TË HIDROCENTRALEVE, TURBINAT ME ERË DHE PANELEVE FOTOVOLTAIKE 7	
2. PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE	10
2.1 PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË TERMOCENTRALE	10
2.2 PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET DHE BURIMET TJERA TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË ELEKTRIKE (BRE).....	10
3. PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TC, HC , TURBINAVE ME ERË DHE PANELEVE FOTOVOLTAIKE	11
3.1. PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TC KOSOVA A.....	11
3.2. PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TC KOSOVA B	12
3.3. PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË	13
4. PLANI I KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.....	15
4.1 HUMBJET E ENERGJISË ELEKTRIKE	15
4.2 KËRKESA DHE HUMBJET NË RRJETIN E SHPËRNDARJES.....	16
4.3 PLANI I NGARKESAVE MAKSIMALE DHE MINIMALE	17
4.4 SHËRBIMET NDIHMËSE.....	19
4.5 IMPORTI I PLANIFIKUAR I ENERGJISË ELEKTRIKE.....	19
4.6 SALDO E BILANCIT VJETOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2025.....	21

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	<i>ver. 0.3</i>	<i>faqe 3 nga 39</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi Afatmesëm</i>

5.	DINAMIKA E PRODHIMIT DHE KONSUMIT TË THËNGJILLIT TË NJOMË ME GJENDJE NË DEPO.....	22
5.1	PLANIFIKIMI I KONSUMIT DHE REZERVAT E THËNGJILLIT.....	23
5.2	PLANIFIKIMI I KONSUMIT DHE REZERVAT E NAFTËS NË TC KOSOVA A.....	24
5.3	PLANIFIKIMI I KONSUMIT DHE REZERVAT E MAZUTIT NË TC KOSOVA B	24
6.	PLANIFIKIMI I RIPARIMEVE DHE REVIZIONEVE TË KAPACITETEVE PRODHUESE	25
7.	EMETIMI I NDOTËSVE TË AJRIT NGA TC KOSOVA A DHE TC KOSOVA B.....	28
7.1	EMETIMET SPECIFIKE TË TC KOSOVA A	28
7.2	EMETIMET SPECIFIKE TË TC KOSOVA B	28
8.	INDIKATORËT E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË SË TERMOCENTRALEVE.....	29
9.	TË DHËNAT E RRJETIT TË TRANSMETIMIT	30
9.1.	TË DHËNAT E KAPACITETEVE TRANSMETUESE (LINJAVE)	30
9.2.	TË DHËNAT E KAPACITETEVE TRANSFORMUESE	30
10.	RIPARIMET, REVIZIONET DHE MIRËMBAJTJA E KAPACITETEVE TRANSMETUESE (LINJAVE) DHE TRANSFORMUESE (NËNSTACIONEVE) DHE PAJISJEVE TË TENSIONIT TË LARTË	31
10.1	PLANI I RIPARIMIT TË LINJAVE	32
10.2	PLANI I RIPARIMEVE, SHQYRTIMEVE TË FUSHAVE, PASTRIMIT TË IZOLATORËVE, SHQYRTIMEVE TË MBROJTJEVE RELE NË NËNSTACIONE	33
10.3	PLANI I RIPARIMEVE ME INTERKONEKSION DHE LINJAVE ME RËNDËSI PËR INTERKONEKSIONIN	37
10.4	PROJEKTET E PARAPARA PËR VITIN 2025.....	38

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	<i>ver. 0.3</i>	<i>faqe 4 nga 39</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi Afatmesëm</i>

HYRJE

Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2025, është përpiluar në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë (Neni 8) si dhe dokumentin Rregulla dhe metodologjia për përgatitjen e bilanceve të energjisë elektrike.

Me qëllim të përpilimit të Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike, KOSTT-i ka marr të dhëna dhe informata nga të gjitha palët relevante të përfshira në tregun e energjisë elektrike.

Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike, është hartuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut KOSTT sh. a.

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	<i>ver. 0.3</i>	<i>faqe 5 nga 39</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi Afatmesëm</i>

BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE

Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike paraqet planin vjetor të shpenzimit të energjisë elektrike në raport me energjinë elektrike në dispozicion. Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike bazohet në nevojat e planifikuara të konsumit të energjisë elektrike për vitin 2025, i cili është parashikuar të furnizohet nga gjenerimi vendor dhe importi i energjisë elektrike. Po ashtu në bilanc parashikohet edhe eksportimi i tepरिकave të energjisë elektrike.

Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike përmban:

- Planin e prodhimit të energjisë elektrike për secilën njësi gjeneruese të secilit central elektrik. Plani do të përmbajë vlerat mujore dhe vjetore për prodhimin e energjisë elektrike, të energjisë që do shfrytëzohet për shpenzime vetjake të centraleve dhe energjisë për ko-gjenerim (TC Kosova B);
- Planin e nevojave të konsumit të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes sipas strukturës së:
 - nevojave të kompanive për shpërndarjen (distribucionin) e energjisë elektrike;
 - nevojave të konsumatorëve të kyçur në transmetim;
 - humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe në rrjetin e shpërndarjes;
- Planin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike.
- Planin e fuqisë në dispozicion në prag të centraleve dhe të fuqisë së nevojshme për të plotësuar kërkesën për fuqi elektrike dhe stabilitet të punës së Sistemit Elektro-Energjetik (SEE).
- Planin e sasisë së nevojshme për lëndët djegëse, bazuar në vlerat kalorike (aftësisë kalorike), për sasinë e planifikuar të prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet;
- Planin e konsumit të energjisë elektrike për nevoja të minierave;
- Planin e prodhimit dhe të konsumit të thëngjillit dhe karburanteve djegëse;
- Planin e remonteve të pajisjeve (stabilimenteve) prodhuese dhe të transmetimit;
- Planin e stabilimenteve dhe objekteve të reja që planifikohen të futen në operim.

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	<i>ver. 0.3</i>	<i>faqe 6 nga 39</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi Afatmesëm</i>

KRITERET E HARTIMIT TË BILANCIT VJETOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Qëllimi kryesor i Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike është që të projektojë përmbushjen e nevojave të konsumatorëve me energji elektrike, në sasi të mjaftueshme gjatë vitit, duke angazhuar kapacitetet e prodhimit dhe transmetimit në mënyrën sa më të mirë tekniko-ekonomike.

Kapacitet aktuale të prodhimit të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës nuk përmbushin nevojën e kërkesës për energji elektrike në baza tarifore. Andaj, për të përmbushur kërkesën për energji elektrike të planifikuar të konsumit të Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2025, paraqitet nevoja për import të energjisë elektrike sidomos gjatë tarifës së lartë (pikut), ndërsa për eksport gjatë tarifës së ultë.

Kriteret kryesore që janë përdor për përgatitjen e dokumentit të Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike 2025, janë paraqitur më poshtë:

- Gatishmëria e njësive gjeneruese të termocentraleve;
- Të dhënat hidrologjike të hidrocentraleve;
- Trendët e konsumit të mëparshëm përkatësisht realizimi i kërkesave nga viti paraprak;
- Rritja mesatare trevjeçare e konsumit;
- Kërkesat e planifikuara të konsumatorëve të kyçur në transmetim;
- Dinamika e prodhimit dhe konsumit të qymyrit dhe karburanteve tjera;
- Plani i mirëmbajtjes së stabilimenteve transmetuese dhe të shpërndarjes;
- Mundësitë teknike të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes dhe
- Implementimi i projekteve, për zhvillimin e rrjetit të energjisë elektrike.

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	ver. 0.3	faqe 7 nga 39
Departamenti: Operatori i Sistemit		Sektori: Planifikimi Afatmesëm

1. KAPACITETET E INSTALUARA TË ENERGJISË ELEKTRIKE

1.1. KAPACITETET E INSTALUARA NË TC KOSOVA A dhe TC KOSOVA B

Në vijim janë paraqitur tabelat me të dhënat e kapaciteteve të instaluar të njësive gjeneruese:

Tabela.1.1. Fuqitë e instaluar të njësive gjeneruese nga TC

Gjeneratorët	Startimi	Fuqia e instaluar		Minimumi teknik i fuqisë së instaluar		Fuqia e mundshme-Realizimi 2023		Minimumi teknik i fuqisë së mundshme aktualisht	
		Në Gjenerator	Në Prag	Në Gjenerator	Në Prag	Në Gjenerator	Në Prag	Në Gjenerator	Në Prag
	viti	MW	MW	MW	MW	MW	MW	MW	MW
A1	1962	65	58	40	36	0	0	0	0
A2	1964	125	110	78	70	0	0	0	0
A3	1970	200	176	138	122	138	128	135	120
A4	1971	200	176	138	122	137	127	135	120
A5	1975	210	186	138	122	139	128	135	120
Kosovë A		800	706	532	472	414	383	405	360
B1	1983	339	307	182	164	267	243	182	164
B2	1984	339	307	182	164	258	239	182	164
Kosovë B		678	614	364	328	525	482	364	328
Kosovë A +Kosovë B		1478	1320	896	800	939	865	769	688

Gjeneratorët A1 dhe A2 në TC Kosova A nuk janë në operim.

1.2. KAPACITETET E INSTALUARA TË HIDROCENTRALEVE, TURBINAT ME ERË DHE PANELEVE FOTOVOLTAIKE

Në vijim janë paraqitur tabelat me të dhënat e kapaciteteve të instaluar të njësive gjeneruese nga HC dhe turbinave me erë.

Tabela.1.2. Fuqitë e instaluar të njësive gjeneruese nga HC dhe turbinat me erë të kyçura në rrjetin e transmetimit

Hidrocentralet dhe Turbinat me erë	Gjeneratori	Viti i lëshimit në punë	Fuqia e dukshme MVA	Fuqia e instaluar MW	Neto (MW)
HC Ujmani	G1	1981	19.5	17.5	16
	G2	1981	19.5	17.5	16
Gjithsejtë HC Ujmani			39	35	32
HC Lumbardhi 1	G1	1957/2005	5.05	4.04	4.00
	G2	1957/2005	5.05	4.04	4.00
HC Lumbardhi 2	G1	2017	6.38	6.2	6.19
HC EGU Belaja	G1	2015	5.88	5.29	5.00
	G2	2015	3.11	2.79	2.50
HC EGU Decani	G1	2015	11.24	6.66	6.50
	G2	2015	5.47	3.15	3.00
Gjithsejtë HC - Kaskada e Lumbardhit (KELKOS)			42.18	32.169	31.189
Gjithsejtë HC të kyçura në Transmetim			81.18	67.17	63.19
Turbinat me ere Air-Energy -KITKA L.L.C	9*G	2018	36.00	32.40	32.40
SOWI KOSOVA-Selaci 1	9*G	2021		34.47	34.47
SOWI KOSOVA-Selaci 2	9*G	2021		34.47	34.47
SOWI KOSOVA-Selaci 3	9*G	2021		34.47	34.47
Gjithsejtë Turbinat me ere SOWI KOSOVA - Selaci			0.00	103.41	103.41
Gjithsejtë Turbina me ere (WP) të kyçura në Transmetim			36.00	135.81	135.81
Gjithsejtë HC dhe turbina me erë të kyçura në Transmetim				202.98	199.00

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	<i>ver. 0.3</i>	<i>faqe 8 nga 39</i>
Departamenti: Operatori i Sistemit		Sektori: Planifikimi Afatmesëm

Tabela.1.3. Fuqitë e instaluar të njësive gjeneruese nga HC në rrjetin e shpërndarjes

Hidrocentrali	Gjeneratori	Viti i lëshimit në punë	Fuqia e instaluar MW
HC Radavci	G1	1934/rindertimi 2010	0.45
	G2	1934/rindertimi 2010	0.45
Gjithsejtë HC Radavci			0.9
HC Burimi	G1	1948/rindertim 2011	0.427
	G2	1948/rindertim 2011	0.427
Gjithsejtë HC Burimi			0.854
HC Dikanci	G1	1957/riparim faza 1-2010	0.5
	G2	1957/riparim faza 1-2010	0.5
	G3	Shkurt 2013/ i ri	2.34
Gjithsejtë HC Dikanci			3.34
HC Brodi 1	G1		2.48
HC Brodi 2	G1	Tipi i turbines Fransis, 2015	2.8
	G2	Tipi i turbines Pelton, 2015	2.2
HC Brodi 3	G	2016	4.7
Gjithsejtë HC Brodi			12.18
HC Restelica 1&2	G1	Tipi i turbines Pelton, 2015	1.2
	G2	Tipi i turbines Pelton, 2015	1.2
HC Restelica 3	G3		2.35
Gjithsejtë HC Restelica			4.75
HC Hydroline-Albaniku II	G1 + G2	2016	3.55
HC Hydroline-Albaniku III	G1 + G2	2020	4.3
HC Hydroline-Albaniku IV	G1	2021	1.1
Gjithsejtë HC Hydroline-Albaniku			8.95
HC Lepenci 3 (Hidroenergji)	G1	2015	4.4
	G2	2015	4.3
	G3	2015	1.3
Gjithsejtë HC Lepenci 3			10
HC Brezovica (Matkos grup)	G1	2015	2.1
HC Binça (EKO Energji)	G1 + G2	2015	1
HC Sharri	G1	2015	6.45
HC Vica	G1	2015	4.6
HC Shterpca	G1	2015	4.9
HC Dragashi (Renelual Tahiri SH.P.K)	G1	2016	3.4
HC Orqusha (Renelual Tahiri SH.P.K)	G1 + G2	2016	4
HC Bresana (Dilli - Energy Sh.P.K.)	G1	2020	0.31
Gjithsejtë HC të kyçura në Distribucion			67.734

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	<i>ver. 0.3</i>	<i>faqe 9 nga 39</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi Afatmesëm</i>

Tabela.1.4 Fuqitë e instaluara të njësive gjeneruese nga turbinat me erë, panelet fotovoltaike dhe biomasa të kyçura në rrjetin e shpërndarjes.

Energjia e ripërtritshme	Gjeneratori	Viti i lëshimit në punë	Fuqia aktive në MW
Turbinat me erë (WP)	G1	2010	0.45
	G2	2010	0.45
	G3	2010	0.45
Gjithsejtë Turbinat me ere			1.35
PS Led Light Tehnology	Panelet fotovoltaike	2015	0.102
PS Birra Peja	Panelet fotovoltaike	2015	3
PS FrigoFood (FF) Kosova	Panelet fotovoltaike	2015	3
PS SOLAR GREEN ENERGY	Panelet fotovoltaike	2019	3
PS N.t.sh. Eling	Panelet fotovoltaike	2015	0.4
PS Centrali elektrik solar fotovoltaike ONIX	Panelet fotovoltaike	2015	0.5
PS PRO ENERGY	Panelet fotovoltaike	2023	3
Gjithsejtë Panelet fotovoltaike			13.002
BM Ngrohtorja e Qytetit SH.A.	G1	2021	1.2
Gjithsejtë			15.552

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	<i>ver. 0.3</i>	<i>faqe 10 nga 39</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi Afatmesëm</i>

2. PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

2.1 PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË TERMOCENTRALE

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike në TC planifikohet deri në vlerën e shfrytëzimit optimal të kapaciteteve prodhuese.

Energjia elektrike e dhënë në prag të transmetimit nga TC Kosova A dhe TC Kosova B planifikohet të jetë: **5064.56 GWh**, ku:

- TC Kosova A = **2,096.75 GWh**, në prag të transmetimit
- TC Kosova B = **2,967.80 GWh**, në prag të transmetimit

2.2 PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET DHE BURIMET TJERA TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË ELEKTRIKE (BRE)

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga HC Ujmani dhe HC-Kaskada e Lumbardhit (KELKOS) (HC Lumbardhi 1, HC Lumbardhi 2, HC EGU Belaja dhe HC EGU Deçani), si dhe nga turbinat me erë (Air-Energy KITKA dhe SOWI KOSOVA (Selaci)) të cilat janë të kyçura në rrjetin e transmetimit planifikohet:

- HC Ujmani = **79 GWh**,
- HC-Kaskada e Lumbardhit = **95.34 GWh**,
- Turbinat me erë Kitka = **91 GWh**,
- Turbinat me erë Sowi Kosova (Selaci) = **249.77 GWh**.

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga hidrocentralet, turbinat e erës dhe panelet fotovoltaike, të kyçura në Sistemin e Shpërndarjes planifikohet të jetë **213.45 GWh**.

Prodhimi i energjisë elektrike i cili hyn në Rrjetin e Transmetimit e prodhuar nga TC Kosova A, TC Kosova B, HC Ujmani, HC-Kaskada e Lumbardhit, turbinat me erë (Kitka dhe Sowi Kosova (Selaci)) për vitin 2025, është planifikuar të jetë **5,579.68 GWh**.

Ndërsa, prodhimi nacional, duke përfshirë edhe HC, turbinat me erë, panelet fotovoltaike dhe nga biomasa të kyçura në Shpërndarje, planifikohet të jetë **5,793.13 GWh**.

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	ver. 0.3	faqe 11 nga 39
Departamenti: Operatori i Sistemit		Sektori: Planifikimi Afatmesëm

3. PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TC, HC , TURBINAVE ME ERË DHE PANELEVE FOTOVOLTAIKE

3.1. PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TC KOSOVA A

Në tabelën 3.1, është paraqitur plani i prodhimit të energjisë elektrike në TC Kosova A: në gjenerator, shpenzimet vetjake (nga skemat e brendshme e TC Kosova A), shpenzimet vetjake nga transmetimi për TC Kosova A dhe prodhimi në prag të transmetimit.

Sipas parashikimit njëkohësisht në operim do të jenë dy njësi të TC Kosova A. Në rastet kur nuk është planifikuar riparim ose revizion, atëherë dy njësi janë në operim e njëra është rezervë.

Tab.3.1. Plani i prodhimit të TC Kosova A

TC Kosova A		Gjithsejtë	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Gjeneratori A3 - Prodhimi në gjenerator	MWh	726 172	95 459	68 185	0	47 730	95 459	0	71 594	95 459	57 957	95 459	3 409	95 459
Gjeneratori A3 - Shpenzimet vetjake	MWh	87 172	11 459	8 185	0	5 730	11 459	0	8 594	11 459	6 957	11 459	409	11 459
Gjeneratori A3 - Prodhimi në prag	MWh	639 000	84 000	60 000	0	42 000	84 000	0	63 000	84 000	51 000	84 000	3 000	84 000
Gjeneratori A4 - Prodhimi në gjenerator	MWh	732 991	0	85 232	95 459	68 185	95 459	92 050	30 683	64 776	57 957	57 957	85 232	0
Gjeneratori A4 - Shpenzimet vetjake	MWh	87 991	0	10 232	11 459	8 185	11 459	11 050	3 683	7 776	6 957	6 957	10 232	0
Gjeneratori A4 - Prodhimi në prag	MWh	645 000	0	75 000	84 000	60 000	84 000	81 000	27 000	57 000	51 000	51 000	75 000	0
Gjeneratori A5 - Prodhimi në gjenerator	MWh	804 585	95 459	27 274	95 459	71 594	0	92 050	95 459	27 274	71 594	40 911	92 050	95 459
Gjeneratori A5 - Shpenzimet vetjake	MWh	96 585	11 459	3 274	11 459	8 594	0	11 050	11 459	3 274	8 594	4 911	11 050	11 459
Gjeneratori A5 - Prodhimi në prag	MWh	708 000	84 000	24 000	84 000	63 000	0	81 000	84 000	24 000	63 000	36 000	81 000	84 000
Kosova A - Prodhimi në gjenerator	MWh	2 263 749	190 919	180 691	190 919	187 509	190 919	184 100	197 737	187 509	187 509	194 328	180 691	190 919
Shp. vetjake nga transm.(T12,T34, T45, T35)	MWh	104 759	9 156	7 445	8 622	9 221	8 990	9 412	8 179	8 088	8 138	9 024	9 118	9 365
Shp. vetjake (nga skemat e brendshme e TC A)	MWh	166 989	13 763	14 246	14 297	13 288	13 929	12 688	15 558	14 421	14 371	14 304	12 572	13 553
Kosova A - Prodhimi në prag të transmisionit	MWh	2 096 759	177 156	166 445	176 622	174 221	176 990	171 412	182 179	173 088	173 138	180 024	168 118	177 365

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	ver. 0.3	faqe 12 nga 39
Departamenti: Operatori i Sistemit		Sektori: Planifikimi Afatmesëm

3.2. PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TC KOSOVA B

Në tabelën 3.2 është paraqitur plani i prodhimit të energjisë elektrike në TC Kosova B: në gjenerator, shpenzimet vetjake (nga skemat e brendshme të TC Kosova B), nga transmetimi për TC Kosova B, shpenzimet e energjisë për ko-gjenerim dhe prodhimi në prag të transmetimit.

Tab.3.2. Plani i prodhimit të TC Kosova B

TC Kosova B		Gjithsejtë	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Gjeneratori B1 - Prodhimi në gjenerator	MWh	1 999 104	197 280	177 552	138 096	19 728	197 280	190 704	197 280	197 280	190 704	105 216	190 704	197 280
Gjeneratori B1 - Shpenzimet vetjake	MWh	175 104	17 280	15 552	12 096	1 728	17 280	16 704	17 280	17 280	16 704	9 216	16 704	17 280
Gjeneratori B1 - Prodhimi në prag	MWh	1 824 000	180 000	162 000	126 000	18 000	180 000	174 000	180 000	180 000	174 000	96 000	174 000	180 000
Gjeneratori B2 - Prodhimi në gjenerator	MWh	1 294 735	178 341	160 507	178 341	154 562	0	0	0	0	39 929	176 447	199 858	206 749
Gjeneratori B2 - Shpenzimet vetjake	MWh	113 407	15 621	14 059	15 621	13 538	0	0	0	0	3 497	15 455	17 506	18 109
Gjeneratori B2 - Prodhimi në prag	MWh	1 181 328	162 720	146 448	162 720	141 024	0	0	0	0	36 432	160 992	182 352	188 640
Kosova B - Prodhimi në gjenerator	MWh	3 293 839	375 621	338 059	316 437	174 290	197 280	190 704	197 280	197 280	230 633	281 663	390 562	404 029
Shp. vetjake nga transmisioni (LP 290, 445/1,445/2)	MWh	22 202	2 328	1 740	2 054	1 953	1 801	1 781	1 790	1 320	1 145	2 268	2 165	1 857
Shp. vetjake (nga skemat e brendshme e TC B)	MWh	266 310	30 573	27 871	25 663	13 314	15 479	14 923	15 490	15 960	19 057	22 404	32 045	33 532
Gjeneratori (B1+B2) kogjenerimi		59 727	12 060	9 763	9 045	3 302	0	0	0	0	0	3 733	9 763	12 060
Kosova B - Prodhimi në prag të transmisionit	MWh	2 967 803	332 988	300 426	281 729	157 674	181 801	175 781	181 790	181 320	211 577	255 526	348 754	358 437

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	ver. 0.3	faqe 13 nga 39
Departamenti: Operatori i Sistemit		Sektori: Planifikimi Afatmesëm

3.3. PLANI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË

Në tabelën 3.3 është paraqitur plani i prodhimit të energjisë elektrike nga HC dhe Turbinat me erë (Kitka dhe Sowi Kosova (Selaci)) të kyçura në rrjetin e Transmetimit si dhe nga HC , turbinat me erë (WP), paneleve fotovoltaike dhe nga biomasa të kyçura në rrjetin e Shpërndarjes.

Tab.3.3. Plan i prodhimit nga HC, turbinave me erë (WP), paneleve fotovoltaike dhe biomasa

Muajt/MWh	Gjithsejtë	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Gjeneratori U1	39 500	2 500	2 500	4 000	5 000	4 000	3 000	3 000	3 000	3 000	3 500	3 000	3 000
Gjeneratori U2	39 500	2 500	2 500	4 000	5 000	4 000	3 000	3 000	3 000	3 000	3 500	3 000	3 000
(1) Gjithsejtë HC Ujmani	79 000	5 000	5 000	8 000	10 000	8 000	6 000	6 000	6 000	6 000	7 000	6 000	6 000
HC Lumbardhi 1	25 180	750	830	1 900	3 700	5 100	3 900	1 500	1 400	900	1 200	2 100	1 900
HC Lumbardhi 2	19 575	600	820	1 150	3 200	3 815	2 800	950	1 000	640	1 100	1 900	1 600
HC EGU Belaje	19 343	620	950	1 200	3 100	4 200	3 100	1 050	590	530	900	1 600	1 503
HC EGU Deçani	31 250	1 250	1 450	2 500	5 100	6 100	4 500	2 300	1 100	650	1 800	2 400	2 100
(2) HC Kaskada e Lumbardhit	95 348	3 220	4 050	6 750	15 100	19 215	14 300	5 800	4 090	2 720	5 000	8 000	7 103
Air-Energy KITKA L.L.C (Turbinat me erë)	91 000	9 800	9 500	9 100	7 300	7 500	5 500	5 700	5 600	6 800	6 700	9 000	8 500
WP Selaci I (Sowi Kosova)	83 257	10 053	11 220	10 053	7 683	6 440	4 290	3 470	2 657	4 290	5 363	7 683	10 053
WP Selaci II (Sowi Kosova)	83 257	10 053	11 220	10 053	7 683	6 440	4 290	3 470	2 657	4 290	5 363	7 683	10 053
WP Selaci III (Sowi Kosova)	83 257	10 053	11 220	10 053	7 683	6 440	4 290	3 470	2 657	4 290	5 363	7 683	10 053
Gjithsejtë Selaci	249 770	30 160	33 660	30 160	23 050	19 320	12 870	10 410	7 970	12 870	16 090	23 050	30 160
(3)=(1)+(2) Prodhimi i HC të kyçura në Transmetim	515 118	48 180	52 210	54 010	55 450	54 035	38 670	27 910	23 660	28 390	34 790	46 050	51 763
HC Restelica 1&2	6 120	487	511	560	667	965	778	374	275	249	242	321	691
HC Restelica 3	7 205	832	592	882	825	936	494	224	260	220	200	773	966
HC Hydroline-Albaniku II	6 996	737	930	1 200	967	670	372	298	260	223	372	409	558
HC Hydroline-Albaniku III	10 869	950	1 250	1 800	1 100	950	744	595	521	446	744	818	950
HC Hydroline-Albaniku IV	3 768	329	434	625	381	329	258	206	180	155	258	284	329
HC Brodi 1	8 402	755	437	676	903	1 383	1 307	442	271	302	355	581	990
HC Brodi 2	13 895	1 072	669	1 064	1 520	3 194	2 471	631	393	432	521	871	1 057
HC Brodi 3	11 180	931	580	1 081	1 367	2 329	1 881	468	262	284	358	658	981
HC Dikance*	11 014	525	765	968	1 764	2 322	1 273	523	444	387	697	648	698
HC Radavci*	3 797	231	242	409	518	554	472	227	166	181	246	234	317
HC Burimi*	2 415	338	249	285	310	368	302	185	90	66	53	51	119
HC Lepenci 3	34 900	2 750	1 700	3 700	4 800	5 600	5 300	3 300	900	500	1 300	1 950	3 100
HC Orqusha (Renelual Tahiri)	16 006	1 350	1 925	2 200	2 596	2 600	1 660	750	250	355	500	820	1 000
HC Dragashi	7 005	556	620	695	844	900	830	730	385	325	280	390	450
HC Vica	16 650	600	1 050	950	2 800	3 000	2 900	1 300	600	550	1 050	950	900
HC Shterpca	19 800	950	1 500	2 100	2 900	3 100	2 900	1 900	950	800	800	950	950
HC Bresana (Dilli - Energy Sh.P.K.)	1 300	70	50	120	180	210	180	120	55	50	75	90	100
HC Brezovica (Matkos grup)	6 620	300	470	650	900	950	850	550	200	400	400	450	500
HC Binqa (EKO Energji)	2 213	196	152	313	309	283	290	95	42	155	177	74	127
PSF N.t.sh. Eling	915	37	58	68	87	98	110	105	107	85	73	52	35
PSF Centrali elektrik solar ONIX	616	19	38	48	62	68	72	80	72	62	52	25	18
PSF Birra Peja	4 237	251	259	378	390	492	502	537	515	357	318	150	88
PSF FrigoFood (FF) Kosova	4 237	251	259	378	390	492	502	537	515	357	318	150	88
PSF Solar Green Energy	4 057	191	247	326	378	415	450	519	489	378	310	189	165
PSF LED LIGHT Technology (LLT)	132	5	8	12	14	14	15	16	15	12	9	6	5
PSF PRO ENERGY	4 238	151	251	344	435	457	517	566	482	392	335	153	155
BM Ngrohtorja e Qytetit SH.A.	4 865	833	753	833	403						403	806	833
Gjeneratorët me erë (WP)*	0												
(4) Prodhimi i HC, PSF dhe TE të kyçura në Shpërndarje	213 452	15 698	15 999	22 665	27 811	32 678	27 431	15 279	8 699	7 723	10 447	12 854	16 170
(3)+(4) Gjithsejtë prodhimi i HC, WP, PS	728 570	63 878	68 209	76 675	83 261	86 713	66 101	43 189	32 359	36 113	45 237	58 904	67 933

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	<i>ver. 0.3</i>	<i>faqe 14 nga 39</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi Afatmesëm</i>

Prodhiimi 2025




Figura 1. Diagrami i prodhimit të energjisë elektrike në përqindje.

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	<i>ver. 0.3</i>	<i>faqe 15 nga 39</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi Afatmesëm</i>

4. PLANI I KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Kërkesa gjithsejtë për energji elektrike në Kosovë për vitin 2025, parashihet të jetë **7,070.66 GWh**. Në këtë kërkesë është planifikuar të merr pjesë:

- Kërkesa neto në Rrjetin e Shpërndarjes (amvisëria, ndriçimi publik, bizneset e vogla etj. të kyçura në nivelin e tensionit 35kV, 10kV dhe 0.4kV) është paraparë të jetë = **5,299.12 GWh**,
- Humbjet në shpërndarje në vlerën = **893.958 GWh**,
- Mihjet = **106.25 GWh**,
- Trepça = **24.00 GWh**,
- SharrCemi = **69.60 GWh**,
- NEWCO Ferronikeli = **422.18 GWh**,
- Shpenzimet e gjenerimit nga transmetimi = **126.96 GWh** (TC A = **104.76 GWh**, TC B = **22.20 GWh**),
- Humbjet në transmetim në sasi prej = **128.58 GWh**.

4.1 HUMBJET E ENERGJISË ELEKTRIKE

Humbjet totale të energjisë elektrike ndahen në:

- **Humbjet teknike në rrjetin e transmetimit**, që paraqesin diferencën e vlerave të matura të energjisë elektrike në hyrje të transmetimit dhe atyre të matura në dalje të rrjetit transmetues. Këtu përfshihen edhe humbjet për shkak të tranzitit (pikat matëse në linjat interkonektive 400, 220 dhe 110kV transferohen në kufijtë ndarës duke përdorur koeficientet e aprovuar të transferimit) dhe
- **Humbjet në rrjetin e shpërndarjes** (distribucionit), që paraqesin diferencën e vlerave të matura të energjisë elektrike të pranuar në pikat e ndarjes nga rrjeti i transmetimit dhe hyrjet nga gjeneratorët e kyçur në shpërndarje dhe në anën tjetër vlerave të matura të energjisë elektrike të dërguar konsumatorëve.

Në planifikimin e humbjeve totale në rrjetin e transmetimit përfshihen humbjet e shkaktuara nga ngarkesa e konsumit të Kosovës dhe humbjet e shkaktuara nga energjia elektrike që kalon si tranzit.

- **Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit** janë planifikuar të jenë **128.58 GWh** e sasisë së gjithmbarshme të energjisë në hyrje të transmetimit.
- **Humbjet totale të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes** sipas të dhënave (humbjet teknike dhe komerciale), janë planifikuar të jenë **893.958 GWh**.

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	ver. 0.3	faqe 16 nga 39
Departamenti: Operatori i Sistemit		Sektori: Planifikimi Afatmesëm

4.2 KËRKESA DHE HUMBJET NË RRJETIN E SHPËRNDARJES

Tab.4.2. Tabela sipas të dhënave të pranuar nga KESCO

(MWh)	Gjithsej	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Kërkesa e Distribucionit	6,003,337	720,517	552,305	529,741	406,569	369,177	350,320	428,052	425,736	388,813	456,296	622,349	753,463
HC Distributive dhe BRE	213,452	15,698	15,999	22,665	27,811	32,678	27,431	15,279	8,699	7,723	10,447	12,854	16,170
HC distributive për konsum univerzal	189,749	13,982	14,189	19,984	24,772	29,369	24,508	13,758	7,870	6,888	9,028	11,031	14,368
Kërkesa totale e Distribucionit	6,193,086	734,499	566,494	549,724	431,341	398,547	374,828	441,810	433,606	395,701	465,323	633,381	767,831
35 kV	61,056	4,566	4,298	5,259	4,682	4,623	4,750	5,520	5,199	5,052	5,033	6,421	5,653
10 kV	521,709	47,914	43,223	43,646	37,430	37,962	38,845	43,657	43,136	38,730	41,929	53,530	51,707
0.4 kV	533,902	49,840	44,043	43,955	37,485	38,587	40,708	47,530	46,690	39,213	41,721	52,272	51,859
0.4/II kV	852,457	86,482	75,326	68,487	57,576	58,361	61,303	75,397	75,526	59,804	60,950	80,590	92,654
Amvisnia	3,285,698	419,869	316,789	291,679	237,731	217,838	188,443	220,252	225,912	190,086	234,502	324,459	418,139
Ndriçimi publik	44,305	4,393	3,859	3,861	3,226	2,992	2,637	2,876	3,172	3,409	4,120	5,029	4,733
Rrjeti Distributiv neto	5,299,127	613,064	487,537	456,887	378,128	360,364	336,685	395,233	399,634	336,294	388,256	522,300	624,745
Humbjet teknike	674,727	91,363	59,359	61,227	38,964	31,572	29,701	42,428	32,541	46,219	52,606	79,747	108,999
Humbjet komerciale	219,231	30,072	19,598	31,610	14,249	6,610	8,442	4,149	1,431	13,188	24,461	31,333	34,088
Total humb. në Rrjetin e Shpërndarjes	893,958	121,435	78,957	92,837	53,213	38,182	38,143	46,577	33,972	59,407	77,067	111,081	143,086

*Diferenca e prodhimit total nga BRE dhe për konsum univerzal ju përket konsumatorëve të parregulluar Trepçë, SharrCem dhe Sowi Kosova (për shpenzime vetanake)

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	ver. 0.3	faqe 17 nga 39
Departamenti: Operatori i Sistemit		Sektori: Planifikimi Afatmesëm


4.3 PLANI I NGARKESAVE MAKSIMALE DHE MINIMALE

Ngarkesat për fuqi maksimale të konsumatorëve janë dërguar nga konsumatorët veç e veç.

Bazuar në karakteristikat bazë të elementeve të sistemit, kushtet e eksploatimit dhe nga simulimi i ngarkesave me programin PSS/E (Power System Simulation for Engineering), është vlerësuar se mundësia transmetuese do të jetë **1850 MW**. Kjo vlen për **Kriterin N** të elementeve të rrjetit. Ndërsa për kriterin N-1 mundësia transmetuese do të jetë **1280 MW**.

Tab. 4.3. Plani i ngarkesave maksimale dhe minimale

Konsumatorët/Ngarkesa (MW)	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Mihjet	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25
SharrCemi	6.5	6.8	12.5	11.8	11.8	11.5	11.5	11.6	12.0	12.5	11.5	10.5
Trepça	5.0	5.0	5.0	5.0	5.0	5.0	5.0	5.0	5.0	5.0	5.0	5.0
NewCo Ferronikeli	49	49	49	49	49	49	49	49	49	49	49	49
Konsumatorët e drejtpërdrejtë	61	61	67	66	66	66	66	66	66	67	66	65
Ngarkesa e kons. në Shpërndarje	1,311	1,272	1,155	947	815	768	765	722	727	869	1,128	1,350
Shpenzimet e TC nga transmissioni	14.0	14.0	14.0	14.0	14.0	14.0	13.0	13.0	12.0	14.0	14.0	14.0
Humbjet në transmissiion (teknike)	20.0	16.1	15.4	12.9	12.5	11.8	12.8	12.8	11.8	13.1	15.4	21.0
Ngarkesa minimale e sistemit	639	507	411	330	317	320	334	363	335	342	399	508
Ngarkesa maksimale e sistemit	1,430	1,388	1,276	1,064	932	884	881	839	842	988	1,248	1,474



	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	<i>ver. 0.3</i>	<i>faqe 18 nga 39</i>
<i>Departamenti: Operatori i Sistemit</i>		<i>Sektori: Planifikimi Afatmesëm</i>

Figura 2. Diagrami i ngarkesave maksimale dhe minimale

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE		DT-OS-007
	ver. 0.3		faqe 19 nga 39
Departamenti: Operatori i Sistemit		Sektori: Planifikimi Afatmesëm	

4.4 SHËRBIMET NDIHMËSE

Në bazë të ngarkesave maksimale të parashikuara, janë llogaritur nevojat për rezervë sekondare të paraqitura në tabelën e më poshtme.

Tab.4.4.1. Rezerva sekondare

Viti 2025	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Ngarkesa (MW)	1430	1388	1276	1064	932	884	881	839	842	988	1248	1443
Rezerva sekondare (MW)	41.8	40.7	37.8	32.1	28.4	27.0	26.9	25.7	25.8	29.9	37.0	42.2

Nevoja për rezervë terciare është paraqitur në tabelën 4.4.2

Tab.4.4.2 Rezerva terciare

Viti 2025	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Rezerva terciare (MW)*	255	255	255	255	255	255	255	255	255	255	255	255

*Rezerva terciare në kuadër të bllokut AK për KOSTT është 197 MW

4.5 IMPORTI I PLANIFIKUAR I ENERGJISË ELEKTRIKE

Bilanci përfshinë në bazë të dhënave në dispozicion dhe përvojës nga vitet paraprake, planifikimin e importit për raste të:

- Pamundësisë së mbulimit të konsumit vetëm nga prodhimi vendor, e sidomos gjatë sezonit dimëror,
- Ndaljeve të shkurtra të paplanifikuara (rënie të njësive gjeneruese),
- Ndaljeve të gjata të planifikuara të njësive gjeneruese, riparimeve dhe revizioneve të njësive gjeneruese dhe të transmetimit,
- Importi për konsum Universal dhe humbje në shpërndarje,
- Importi për furnizim të konsumit të Ferronikelit, SharriCemit dhe Trepçës, si konsumator të parregulluar,
- Importi për humbje në transmetim,
- Importi për furnizim nga Elektroserveri.

Sasia e planifikuar për import për konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal dhe importi për mbulimin e humbjeve në OSSH është **878.60 GWh**, e paraqitur në baza mujore si në tabelën e më poshtme.

Tab. 4.5. Planifikimi i importit për konsum universal dhe për humbje në Shpërndarje

Muajt/MWh	Gjithsej	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Importi për konsum Universal	318 206	57 396	6 140	15 031	21 147	3570	5 217	46 623	62 459	11993.7	16 408	21 167	51 054
Importi për humbje në Shpërndarje	560 395	94 282	43 341	36 248	36 539	19270	23 590	34 492	25 779	31839.5	34 665	69 506	110 843
Gjithsejtë Import	878 601	151 678	49 481	51 279	57 686	22 840	28 807	81 115	88 238	43 833	51 074	90 673	161 897

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	ver. 0.3	faqe 20 nga 39
Departamenti: Operatori i Sistemit		Sektori: Planifikimi Afatmesëm

Tab.4.5.1. Importi i konsumatorëve të kështu drejtpërdrejt në Transmetim

Muajt/MWh	Gjithsej	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Import i SharrCemit	69 600	2 700	2 500	6 200	6 700	6 700	6 600	6 100	6 200	6 400	6 500	6 600	6 400
Importi i Trepçës	24 000	2 000	2 000	2 000	2 000	2 000	2 000	2 000	2 000	2 000	2 000	2 000	2 000
Importi i Ferronikelit	422 184	36 456	32 928	34 104	35 280	36 456	32 928	36 456	36 456	32 928	36 456	35 280	36 456

Tab.4.5.2. Importi për humbje në Transmetim

Muajt/MWh	Gjithsej	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Importi për humbje në Transmetim	94 673	12 468	8 561	7 265	7 182	6 433	6 018	7 105	7 080	5 188	5 192	9 241	12 941

Tab.4.5.3. Importi për furnizim nga Elektroseveri

Muajt/MWh	Gjithsej	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Importi për furnizim nga Elektroseveri	279 000	37 000	35 000	34 000	22 000	18 000	13 000	12 500	11 500	12 000	19 000	29 000	36 000

	BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-OS-007
	ver. 0.3	faqe 21 nga 39
Departamenti: Operatori i Sistemit		Sektori: Planifikimi Afatmesëm

4.6 SALDO E BILANCIT VJETOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2025

Tab.4.6. Bilanci 2025

	MWh	Gjithsej	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
